



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

Nr. 287 Prot.

Tiranë, më 24.01.2022

Lënda: Përcillen të dhëna dhe prova që kërkojnë domosdoshmërisht nisjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

DREJTUAR: **KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT**

PËR DIJENI: **KRYETARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Tiranë

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 124/2, 126, 128, 179), ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, (nenet 10, 10/a, 10/b, 10/c, 10/ç, 86 pika 1); ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 5, pika 3, germa “a”).

Të nderuar Anëtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

I. Hyrje

Në mbështetje të nenit 179, pika 7, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 10, 86 pika 1 të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, si dhe nenit 5, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji i Posaçëm i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese përgjatë mandatit të tij 9-vjeçar është përcaktuar si institucioni kushtetues që ka juridiksionin dhe kompetencën e shqyrtimit të çështjeve/shkeljeve disiplinore të konsumuara prej gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Siç dhe jeni në dijeni, shkeljet disiplinore të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, fillimi dhe zhvillimi i procesit disiplinor janë të parashikuara në nenin 128 të Kushtetutës, nenin 10, 10/a - 10/ç të ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar. Për lehtësinë tuaj, në këtë kërkesë si fillim po e vë në dukje se përmbajtjen e këtyre dispozitave.

Neni 128, Kushtetutës, parashikon se:

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese **mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit.**
2. Procesi disiplinor ndaj gjyqtarit zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos për shkarkimin e tij kur:
 - a) **konstaton shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të mandatit;**
 - b) **dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.**
3. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje;
 - c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.”

Ligji nr. 8577/2000, në nenet 10 dhe 10/a, parashikon shprehimisht se :

“Neni 10

Shkeljet disiplinore

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore, veçanërisht për shkaqe të:

1. Mosparaqitjes së kërkesës për heqje dorë nga procedimi apo gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit procedural dhe gjyqtari është në dijeni të rrethanave të tilla.
2. Sjelljes, akteve dhe veprimeve të tjera të gjyqtarit që krijojnë përfitime të padrejta **ose dëme për palët pjesëmarrëse në gjykim.**
3. Mosnjoftimit të Kryetarit të Gjykatës ose të organeve kompetente, sipas ligjit, për ndërhyrjet apo ushtrimin e formave të tjera të ndikimit të papërshtatshëm nga avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë dhe subjekte të tjera.
4. Ndërhyrjeve ose çdo lloj ndikimi tjetër të papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës të një gjyqtari tjetër.
5. Mosnjoftimit të Kryetarit dhe të institucioneve përgjegjëse **për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit të tij.**
6. Mospërmbushjes së pajustificuar e në mënyrë të qëllimshme ose të përsëritur, përkatësisht të funksionit të tij.
7. Paraqitjes së kërkesës për heqje dorë dhe kryerjes së atyre veprimeve që nuk bazohen në shkaqet e parashikuara në ligj ose që bëhen në mënyrë të qëllimshme për të krijuar përfitime të padrejta për palët dhe të tretët, ose kur synojnë të shmangin gjyqtarin nga detyrimi ligjor për shqyrtimin e çështjes ose synojnë të krijojnë mundësinë e shqyrtimit të saj nga gjyqtarët të tjerë ose kur dorëheqja jepet e vonuar megjithëse ka qenë në dijeni të faktit për të cilin jep dorëheqjen.

8. Shkeljes së përsëritur ose të rëndë të rregullave të solemnitetit dhe rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me pjesëmarrësit në proces, si edhe me gjyqtarë ose administratën e Gjykatës Kushtetuese.
9. Vonesës dhe zvarritjes së përsëritur dhe të pajustificuar të veprimeve procedurale dhe gjatë ushtrimit të funksionit.
10. Bërjes publike të mendimeve që ka dhënë vetë ose gjyqtarët e tjerë gjatë procesit që akoma nuk kanë marrë formën e një akti të bërë publik.
11. Shkeljes së detyrimit të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces apo i përfunduar, duke përfshirë lehtësinë e publikimit dhe shpërndarjes, gjithashtu edhe për shkak të neglizhencës, të akteve konfidenciale ose akteve procedurale ose informacioneve konfidenciale që rrjedhin nga çështjet të cilat janë në proces hetim ose gjykimi.
12. Bërjes së deklaratave publike dhe në media, për çështjet, me përjashtim të komunikimeve të shtypit brenda kufijve të detyrës së tij.
- 13. Parashtrimi të shtrembëruar të fakteve në aktet e nxjerra.**
14. Përdorimit të mandatit të gjyqtarit, me qëllim për të realizuar përfitime të pajustificuara ose përfitime për vete ose për të tjerët.
15. Shoqërimit me persona që janë nën ndjekje penale ose janë subjekte të një procedimi penal, ose me persona të dënuar penalisht, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar, ose persona të cilët janë të afërm me gjyqtarët në lidhje gjaku ose me ligj, dhe pasja e marrëdhënieve biznesi të papërshtatshme me këta persona.
- 16. Përfitimit të padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat, qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e përdorimit prej tij të pozicionit të magjistratit.**
17. Sjelljes së papërshtatshme në përmbushjen e detyrimeve, në marrëdhëniet dhe në komunikimin me institucionet shtetërore dhe funksionarët e tyre, dhe raste të tjera me sjellje të papërshtatshme të pajustificuar.”

“Neni 10/a

Fillimi dhe zhvillimi i procedimit disiplinor

1. Kur ka të dhëna të mjaftueshme se një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka kryer shkelje të parashikuara në nenin 128, të Kushtetutës, dhe në nenin 10, të këtij ligji, me kërkesë të Kryetarit ose të çdo gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, Kryetari, ose gjyqtari më i vjetër në detyrë, kur subjekt i procedimit është Kryetari, merr masat për fillimin e procedimit disiplinor.
2. Procedimi disiplinor fillon menjëherë nga momenti i konstatimit të shkeljes. Procedimi disiplinor pushon nëse gjyqtari jep dorëheqjen. Në këtë rast ai nuk ka të drejtë të emërohet më në funksione publike për një periudhë 15-vjeçare.
3. Dy gjyqtarë të caktuar me short mbledhin fakte, prova dhe të dhëna të tjera lidhur me shkeljen që i atribuohet gjyqtarit dhe brenda 30 ditëve përgatisin relacionin përkatës dhe ia dërgojnë atë për shqyrtim Komisionit Disiplinor.

4. Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të caktuar me short, pa pjesëmarrjen e gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhjen e fakteve dhe provave, sipas pikës 3 të këtij neni. Komisioni merr në shqyrtim relacionin e paraqitur dhe vendos dhënien e masës disiplinore, sipas nenit 10/b, të këtij ligji, ose pushimin e çështjes për shkak se nuk provohet shkelja.

5. Gjyqtari, subjekt i procedimit, ka të drejtë të ushtrojë ankim ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor. Ankimi shqyrtohet nga komisioni ad hoc i përbërë nga tre gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, që nuk kanë marrë pjesë në procedim, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni.

Parashikimet e këtyre dispozitave në krahasim me rrethanat e faktit, provat e marra sipas formës së kërkuara nga ligji dhe me të cilat Presidenti i Republikës është njohur zyrtarisht së fundmi nga Gjykata Kushtetuese, e që kanë lidhje me një çështje të shqyrtuar së fundmi nga kjo gjykatë, na detyrojnë që t’ju përcjellim këtë informacion të shoqëruar me prova bindëse të cilat konfirmojnë se, ka të dhëna mëse të mjaftueshme se nga një apo disa gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese janë konsumuar shkelje të rënda profesionale dhe etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të mandatit, veprimtari kjo në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8577/2000, e që sipas parashikimeve të nenit 128 të Kushtetutës dhe nenin 10, 10/a të ligjit nr. 8577/2000, kërkojnë që nga ana juaj të merren masa për fillimin menjëherë të procedimit disiplinor.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vitore Tusha, Kryetare, Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Altin Binaj, Përparim Kalo, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Enina Kotoni, në datat 23.06.2021 dhe 02.11.2021, ka shqyrtuar në seancë plenare publike çështjen nr. 7 (S) 2019 të Regjistrimit Themeltar, që i përkiste këtyre palëve: **Kërkues** Shoqata e Bashkive të Shqipërisë; **subjekte të interesuara** në këtë gjykim, Presidenti i Republikës, Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Avokati i Popullit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Partia “Bindja Demokratike”; me **objekt**: 1. Konstatimi antikushtetues i zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor të zhvilluar më 30 qershor 2019 për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, të kryetarëve të bashkive dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë dhe, si rrjedhojë, konstatimi antikushtetues i zgjedhjes së anëtarëve të këtyre organeve; 2. Verifikimi i kushtetutshmërisë së veprimtarisë së partisë “Bindja Demokratike” në lidhje me regjistrimin e saj në gjykatë dhe zgjedhjet e datës 30 qershor 2019.

Gjykata Kushtetuese, duke vlerësuar se në lidhje me kërkimin e parë të kërkesës në shqyrtim çështja nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues, kurse në lidhje me kërkimin e dytë kërkuesja nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, në përfundim me Vendimin nr. 36, datë 04.11.2021, vendosi: **“Rrëzimin e kërkesës”**.

Ky vendim është marrë në datën 04.11.2021, dhe është shpallur i arsyetuar në datën 02.12.2021, si dhe i është njoftuar zyrtarisht institucionit të Presidentit të Republikës, si palë e interesuar në proces,

përmes shkresës së Gjykatës Kushtetuese nr. prot. 7 (S) 2019 Regj.Them., datë 2.12.2021, protokolluar pranë nesh me nr. prot. 3803/1, datë 6.12.2021.

Menjëherë pas shpalljes së arsytuar të këtij vendimi prej Gjykatës Kushtetuese dhe njohjes zyrtarisht me përmbajtjen e tij, Presidenti i Republikës, si subjekt i interesuar në këtë proces gjyqësor, përmes Letrës Nr.3803/2 Prot., datë 9.12.2021, i kërkoi Gjykatës Kushtetuese, vënien në dispozicion të një kopje të të gjithë dosjes gjyqësore të këtij vendimi, dokumentacion ky që duhet të përfshinte të gjithë procesverbalet në formatin që disponohen dhe administrohen nga Gjykata (si në format të zbardhur shkresor, ashtu edhe atë elektronik audio në CD), e që pasqyrojnë në mënyrë kronologjike hapat proceduralë dhe aktet që dokumentojnë këto hapa dhe vendimmarrjet përkatëse, që nga momenti fillestar i depozitimit të kërkesës prej shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, **mënyrën e caktimit të relatorit të çështjes, diskutimet në Kolegj dhe Mbledhjen e Gjyqtarëve, si dhe të gjitha fazat nëpër të cilat ka kaluar shqyrtimi i kësaj çështjeje deri në zhvillimin e seancës gjyqësore publike përfundimtare e shpalljen e vendimit.**

Gjykata Kushtetuese përmes shkresës nr. prot. 466/1, datë 16.12.2021, administruar më datën 16.12.2021, me nr. prot. 3808/3, i ka përcjellë Institucionit të Presidentit të Republikës të inventarizuar sipas listës bashkëlidhur një kopje të të gjithë dosjes gjyqësore.

Pas shqyrtimit të të gjithë dosjes gjyqësore që na është përcjellë nga Gjykata Kushtetuese, rezultojnë disa të dhëna e fakte që bëjnë të detyrueshme t'ju përcjellim këtë informacion të shogëruar me prova bindëse të cilat konfirmojnë se, ka të dhëna mëse të mjaftueshme se një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe konkretisht zonja Fiona Papajorgji dhe relatore e kësaj çështje ka konsumuar shkelje të rënda profesionale dhe etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të mandatit.

Përsa rezulton në dosje ekziston dyshimi ynë se në këtë veprimtari në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8577/2000, mund të jenë përfshirë edhe disa anëtarë të tjerë të Gjykatës Kushtetuese.

Këto të dhëna sipas parashikimeve të nenit 128 të Kushtetutës dhe nenin 10, 10/a të ligjit nr. 8577/2000, kërkojnë domodosmërisht që nga ana juaj të merren masa për fillimin menjëherë të procedimit disiplinor dhe të merren masa emergjente dhe të themelta në lidhje me këtë procedim disiplinor sipas ligjit.

Duke qenë se Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka mundësi praktike të marrë dijeni mbi shkeljet profesionale apo etike përgjatë një shqyrtimi gjyqësor kushtetues të një apo gjithë trupës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, e cila për shkak të shkeljeve të konsumuara, nuk ka interes të njoftojë Kolegjin (pikërisht të faktit se mund të jenë përfshirë shumë anëtarë të trupës gjyqësore), Presidenti i Republikës, si Kreu i Shtetit, si institucioni kushtetues i pavarur me rol të veçantë e të pazëvendësueshëm në zgjidhjen e krizave, përfaqësues i unitetit të popullit, dhe që ka për detyrë të monitorojë funksionimin normal të mekanizmave kushtetues, duke ndërhyrë për eliminimin e

mangësive në këtë drejtim¹, në përmbushje të rolit dhe misionit të tij kushtetues, dhe si palë pjesëmarrëse në procesin gjyqësor kushtetues ku janë konstatuar shkeljet, i paraqet Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, këtë material informues mëse të mjetueshëm dhe të arsyetuar, të shoqëruar me prova të siguruara nga vet Gjykata Kushtetuese, **në mënyrë që Kolegji i Posaçëm i Apelimit, të njihet dhe të vihet në dijeni mbi këto shkelje procesionale dhe etike, dhe të fillojë procedimin disiplinor sipas kërkesave të Kushtetutës dhe Ligjit.**

II. Faktet dhe rrethanat

Më poshtë gjeni të renditura në mënyrë sistematike faktet që diktojnë nevojën për nisjen e procedimit disiplinor të Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Këto fakte janë evidentuar pasi Presidenti i Republikës, me shkresën nr. 3803/2 Prot., datë 9.12.2021, i kërkoi me shkrim Gjykatës Kushtetuese të dhëna dhe kopje të praktikës mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe vendimmarrjes nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese përcolli të dhënat dhe kopjen e dosjes përmes shkresës nr. prot. 466/1, datë 16.12.2021, administruar pranë Institucionit të Presidentit të Republikës në datën 16.12.2021, me nr. prot. 3808/3.

1. Në datën 18.7.2019, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë i është drejtuar me një kërkesë Gjykatës Kushtetuese, duke i kërkuar kësaj gjykate : *“1. Konstatimi antikushtetues i zgjedhshmërisë/procesit zgjedhor të zhvilluar më 30 qershor 2019 për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore, të kryetarëve të bashkive dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë dhe, si rrjedhojë, konstatimi antikushtetues i zgjedhjes së anëtarëve të këtyre organeve; 2. Verifikimi i kushtetutshmërisë së veprimtarisë së partisë “Bindja Demokratike” në lidhje me regjistrimin e saj në gjykatë dhe zgjedhjet e datës 30 qershor 2019.”.*

2. Kjo kërkesë është regjistruar me Nr. 7(S) 2019, datë 18.7.2019 pranë Gjykatës Kushtetuese dhe sipas Kartelës shoqëruese ka kaluar automatikisht tek Gjyqtare Vitore Tusha, e cila ishte e vetmja gjyqtare në detyrë në atë moment. Ndërkohë që Këshilltare është caktuar zonja Koliana Nushi.

3. Në datat 11 - 13 nëntor Gjykata Kushtetuese u plotësua edhe me 3 anëtar të rinj të emëruar nga Kuvendi i Shqipërisë zonjën Elsa Toska dhe zonjën Fiona Papajorgji dhe nga Presidenti i Republikës zonjën Marsida Xhaferllari. Në muajin dhjetor 2019 Gjykata Kushtetuese ishte e përbërë me katër anëtarë, ku përfshihen këta anëtar të rinj dhe Kryetarja në detyrë zonja Vitore Tusha.

¹ Detyra e tij si përfaqësues i unitetit të popullit është të mbikëqyrë funksionimin normal të mekanizmave kushtetues, duke ndërhyrë për eliminimin e mangësive në këtë drejtim (shih vendimin nr. 76, datë 25.04.2002 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin nr. 26 datë 25.05.2021).

4. Në kartelën shoqëruese të kërkesës ka një shënim me këtë përmbajtje *“Rishortim i dosjes me qëllim shpërndarjen e çështjeve tek gjyqtarët e rinj”*. Pra tek zonja Elsa Toska, Fiona Papajorgji, apo Marsida Xhaferllari.

5. Në nenin 27, pika 6, të ligjit nr. 8577/2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”*, të ndryshuar përcaktohet shprehimisht se:

“6. Kërkesa e regjistruar në regjistrin e kërkesave i dorëzohet Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili merr masat për caktimin me short të relatorit të çështjes, sipas Rregullores së Gjykatës”.

Pra caktimi i relatores për çdo çështje është e detyrueshme që sipas ligjit të kryhet në mënyrë rastësore me short, që sipas rregullores, rastit dhe traditës ose do duhet të hidhet manualisht përmes goglave në mënyrë rastësore, ose përmes sistemeve elektronike që gjykatat mbajnë dhe administrojnë në përditshmërinë e tyre, sipas ligjit.

6. Ndërkohë që Neni 5, i Rregullores² **“Mbi gjykimin kushtetues dhe funksionimin e administratës”**, në dispozitën me titull **“Kontrolli administrativ i kërkesave”**, parashikon:

“Në rast se kërkesa i plotëson të gjitha kushtet formale të përmendura në nenin 4/2, Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit e regjistron kërkesën në Regjistrin e Kërkesave dhe ia paraqet atë Kryetarit të Gjykatës, i cili cakton relatorin për përgatitjen e çështjes për shqyrtim.”

Në këtë pjesë të Rregullores, fjala short nuk citohet shprehimisht, por gjen zbatim direkt parimi i hierarkisë së akteve ligjore dhe nënligjore, ç’ka natyrshëm bën të detyrueshëm hedhjen e shortit për caktimin e relatorit dhe për asnjë rrethanë procedura e hedhjes së shortit nuk mund të shmanget, pasi rregullorja as mund të dalë mbi ligjin, por as nuk e parashikon shmangien e hedhjes së shortit. Edhe sikur për një moment të prezumojmë faktin se anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese ishin zgjedhur në datë 11-13 nëntor 2019, dhe nuk kishin patur mundësi të merrni masat për të azhurnuar Rregulloren e hedhjes së shortit, njësoj me përmbajtjen e dispozitës ligjore, kjo as që diskutohet në rastin në fjalë pasi pikërisht dy nga anëtarët e reja, zonja Papajorgji dhe zonja Toska, ishin në marrëdhënie pune prej vitesh në Gjykatën Kushtetuese dhe nuk duhej të pranonin caktimin e tyre si relatores, pa ndjekur procedurat e shorti siç ligji dikton. Nëse këto veprime kanë qenë me dashje apo të paramenduara, apo për shkaqe të tjera, kjo do të duhet të jetë pjesë e hetimit disiplinor të gjyqtarit, qoftë të atij që ka shprehur dëshirën apo ka pranuar dosjen, qoftë dhe të mënyrës së caktimit nga Kryetari.

7. Pra nga kopja e dokumentacionit të përcjellë, rezulton se në 3 dhjetor 2019, është bërë caktimi i Fiona Papajorgjit si Relatore e kësaj çështjeje nga Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese. Në kartelën

² Shiko aktet ligjore mbi të cilat funksionon GJK, publikuar nga kjo Gjykatë në eeb-in e saj në këtë link: https://www.gjk.gov.al/web/Baza_ligjore_98_1.php

shoqëruese ka vetëm një shënim me këtë përmbajtje “*Caktohet relatores znj. Fiona Papajorgji. Këshilltarja nuk ndryshon dt. 3.12.2019.*”

8. Zonja Fiona Papajorgji e ka marrë në dorëzim dosjen gjyqësore të nesërmen më datë 4.12.2019. Në kartelë ka një shënim me këtë përmbajtje “*Marrë në dorëzim: Fiona Papajorgji datë 4/12/2019*”, si dhe nënshkrimin përkatës.

9. Në dosje nuk evidentohet ndonjë procesverbal i datës 3.12.2019, mbi hedhjen e shortit për rishortimin e kësaj dosjeje. As ndonjë urdhër i Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese për caktimin e relatores për çështjen. Pra është tërësisht e paqartë dhe e pazbardhur se si i është caktuar zonja Fiona Papajorgji si relatores për këtë dosje. Duke prezumuar kështu faktin që, ose **zonja Papajorgji ka shprehur dëshirën**, ose është caktuar nga Kryetarja e Gjykatës si relatores e çështjes, **pa hedhur një procedurë shorti si kërkesë taksative e ligjit.**

Ky fakt meriton një hetim të plotë disiplinor për t`iu përgjigjur pyetjeve të shumta, veçanërisht nëse:

- Cila është arsyeja që ka çuar në një shpërndarje të tillë të çështjes së zgjedhjeve vendore 2019?
- A është shkelur hapur neni 27/6 e ligjit nr. 8577/2000 ?
- A ka patur apo shprehur zonja Papajorgji ndonjë preferencë për marrjen e kësaj dosje për relativ, duke qenë se ajo është zgjedhur nga organi i emërtesës - Kuvendi i Shqipërisë në datë 11.11.2019, si kandidaturë e vetme në listën që ky organ ka vlerësuar në dispozicion të dërguar nga KED?
- A është shpërndarja e dosjeve pa short në Gjykatën Kushtetuese, një fenomen i izoluar si ky rast i provuar, apo kjo është një mënyrë veprimi me të gjitha dosjet në Gjykatën Kushtetuese, pas muajit nëntor 2019, kohë kjo kur kjo Gjykatë u plotësua me anëtarët e rinj?

Nëse ky është një fenomen masiv, atëherë procedimi disiplinor duhet të shtrihet sipas kërkesave të ligjit ndaj kujtdo gjyqtari të përfshirë në këto shkelje profesionale dhe etike.

10. Në datë 24.12.2019, Kolegji i përbërë nga Fiona Papajorgji relatores, Elsa Toska dhe Vitore Tusha kanë vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. (Në këtë moment gjykata ishte e përbërë vetëm nga 4 anëtarë). Sipas nenit 133, pika 1 të Kushtetutës, si dhe nenit 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, në të gjitha ato raste, kur ndonjë nga gjyqtarët e kolegjit nuk është i një mendimi me të tjerët, kërkesa i kalon për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve. **Rezulton se sipas vendimmarrjes së zbardhur më tej, është pikërisht zonja Fiona Papajorgji, edhe në cilësinë e Relatores, që ka qenë kundër kalimit të çështjes në seancë gjyqësore publike.**

11. Në datë 7.4.2021, Mbledhja e Gjyqtarëve tashmë me 7 anëtarë, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike. **Fakt është që zonja Fiona Papajorgji, ka votuar kundër kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, duke qëndruar në mendim pakice, pozicion ky që i lidhur me veprimet e marrjes së dosjes pa short si relatores dhe me veprimet e mëtejshme të parregullta të kryera nga ky gjyqtar, tregojnë për shkaqe**

njëanshmërie të kësaj gjyqtare, ç'ka është e papranueshme për figurën e një gjyqtari kushtetues.

12. Në këtë vendimmarrje të datës 7.4.2021, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur të thirren si subjekte të interesuara në këtë gjykim kushtetues, Presidenti i Republikës, Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Avokati i Popullit, KQZ, Partia Bindja Demokratike.

13. Në datë **23.06.2021**, në fund të seancës, Gjykata Kushtetuese në mënyrë të papritur për palët, vendosi: ***“Pezullimin e çështjes duke kërkuar amicus curia në Komisionin e Venecias. Ti bëjë me dije palëve se kanë të drejtë të propozojnë nga një pyetje secila nga këto palë pjesëmarrëse në proces, që në vlerësimin e tyre është thelbësore për këtë çështje, deri më datë 25.6.2021, ora 16:00³.”***

Ky është vendimi i ndërmjetëm që Gjykata Kushtetuese mori në seancën gjyqësore publike të zhvilluar më datë 23.6.2021.

14. Në nenin 44/b të ligjit nr. 8577/2000, parashikohet se:

“1. Nëse Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të çështjes, vendos të kërkojë një opinion këshillimor nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, lidhur me zbatimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe protokolleve shtesë të saj ose të kërkojë amicus curia nga organizma të tjerë, ajo vendos pezullimin e shqyrtimit të çështjes.

2. Seanca rihapet menjëherë pas marrjes së opinionit këshillimor nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ose amicus curia. Opinioni i marrë u njoftohet palëve bashkë me datën e seancës”

15. Në datë **25.6.2021** bazuar në detyrat e lëna nga trupa gjyqësore në seancën e datës **23.6.2021**, Zyra e Avokatisë MLC, që përfaqësonte subjektin Bindja Demokratike si person i interesuar në këtë proces gjyqësor, i ka parashtruar Gjykatës Kushtetuese pyetjen e saj për ta përcjellë në Komisionin e Venecias. Konkretisht pyetja e përcjellë ka këtë përmbajtje:

“A mundet të kërkohet deklarimi si antikushtetues i një partie politike bazuar në pretendime për parregullsi në regjistrimin si subjekt zgjedhor?”

Kjo kërkesë është administruar me Numër Protokolli 7 (S) 2021 XI, datë 25.6.2021, nga ana e Gjykatës Kushtetuese, pra brenda afatit të përcaktuar prej saj.

16. Në datë **25.6.2021** bazuar në vendimin e ndërmjetëm të trupës gjyqësore të marrë në seancën e datës 23.6.2021, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, përmes Zyrës së Avokatisë Daci & Associates, si subjekt i interesuar në këtë proces gjyqësor, i ka parashtruar Gjykatës Kushtetuese

³ **Shiko Procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 23.6.2021.**

pyetjen e saj për ta përcjellë në Komisionin e Venecias. Konkretisht, pyetja e përcjellë ka këtë përmbajtje:

“A është Dekreti i Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe ai për anulimin e saj, një akt me karakter të përgjithshëm ose akt normativ kushtetues apo është një akt administrativ nënligjor individual dhe në çdo rast, a mund të refuzohet zbatimi i tyre nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sikurse ka ndodhur, apo duhet që këto dekrete t’ju nënshtroheshin vlerësimit mbi kushtetutshmërinë vetëm nga Gjykata Kushtetuese mbi bazën e kërtimeve të subjekteve që kishin pretendime në përputhje me kriteret kushtetuese për vënien në lëvizje të kësaj gjykate?”

Kjo kërkesë është administruar me **Numër Protokollit 7 (S) 2021 XI, datë 25.6.2021**, nga ana e Gjykatës Kushtetuese, pra brenda afatit të përcaktuar prej saj.

17. Presidenti i Republikës, Kuvendi i Shqipërisë, Kryeministri, Këshilli i Ministrave, Avokati i Popullit, rezultojnë se nuk paraqitën pyetje për t’u dërguar në Komisionin e Venecias.

18. Në datë 9.7.2021, rezultojnë se Gjykata Kushtetuese me shkresën nr. 291 prot., datë 9.7.2021, i drejtohet Komisionit të Venecias, duke i parashtruar **vetëm 3 pyetje dhe konkretisht**, në pikën 14 të vendimit të saj Gjykata Kushtetuese, citon shprehimisht se:

*“14. Gjykata, pasi vlerësoi edhe pyetjet e paraqitura nga palët, me shkresën nr. 291 prot., datë 09.07.2021, i dërgoi Komisionit të Venecias kërkesën për dhënien e një opinioni *amicus curiae*, duke parashtruar pyetjet që ajo çmoi se kishin rëndësi për disa nga aspektet kryesore të këtij gjykimi, si më poshtë:*

***Pyetja nr. 1:** A mund të interpretohet neni 131, pika 1, shkronja “e”, i Kushtetutës së Gjykatës Kushtetuese ka juridiksion për të vendosur për kushtetutshmërinë e procesit zgjedhor?*

***Pyetja nr. 2:** Duke qenë se parimi i periodicitetit të zhvillimit të zgjedhjeve vendore dhe ai i pluralizmit politik janë parashikuar si parime themelore kushtetuese, cili do të ishte raporti mes tyre në një situatë ku rrezikohet cenimi i secilit parim? Cili parim do të prevalonte mbi tjetrin?*

***Pyetja nr. 3:** Në një situatë të një klime pasigurie juridike, a ka cenuar sjellja e autoriteteve publike dhe e partive politike të drejtën e votuesve për të pasur mundësi kuptimplotë zgjedhjeje? A duhet ata të siguronin interesin më të lartë të votuesve?*

19. Në krahasim të përmbajtjes së pyetjeve të dërguara nga Gjykata me ato të parashtruara nga palët, rezultojnë se asnjë prej pyetjeve të palëve (*Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe Partisë Bindja Demokratike*) **nuk i është përcjellë Komisionit të Venecias.**

20. Nga praktika dokumentare që vetë Gjykata Kushtetuese i vuri në dispozicion Presidentit të Republikës, midis **datave 25.6.2021 dhe 9.7.2021**, moment ky kur është hartuar shkresa e Gjykatës

Kushtetuese drejtuar Komisionit të Venecias, **dosja gjyqësore nuk përmban asnjë dokument për të dokumentuar;**

- mënyrën se si u formuluan pyetjet e Gjykatës Kushtetuese për në Komisionin e Venecias;
- kush është autoriteti që vendosi që pyetja e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe pyetja e Partisë Bindja Demokratike ishin të panevojshme, apo të mos i përcilleshin Komisionit të Venecias?
- Si mund të mos i dërgoheshin Komisionit të Venecias pyetjet e palëve sidomos pyetja e kërkuarit që ishte dhe thelbi i çështjes, ndërkohë që ishte vet Gjykata Kushtetuese e cila me vendim të datës 23.6.2021, jua njohu palëve këtë të drejtë?!?!

Pra kjo pjesë e veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese nuk pasqyrohet si e zbardhur në asnjë dokument, ç'ka krijon bindjen që Relatori i çështjes, zonja Papajorgji, që përgjigjet për ndjekjen dhe ecurinë e dosjes me veprimet e saj, ka shmangur dërgimin e pyetjeve dhe i ka paraqitur Kryetarit të Gjykatës për nënshkrim vetëm tre pyetje që janë ngritur prej saj.

Referuar dokumentacionit të dosjes gjyqësore, është krejtësisht e paqartë se si ka ndodhur kjo, dhe ky fakt në vetvete, që cenon dukshëm parimin e transparencës së Gjykatës Kushtetuese, kërkon hetim disiplinor të thelluar nga organi procedues për të arritur në një nivel objektiv përfundimesh se cila ka qenë përfshirja e relatores apo e anëtarëve të tjerë të Gjykatës Kushtetuese në këtë shkelje të procedurës së marrjes së një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Nga hetimi disiplinor që do të kryejë Kolegji i Posaçëm i Apelimit, që do të duhet të përfshijë dhe dhënien e shpjegimeve prej trupës gjyqësore kushtetuese, mund të rezultojë që edhe anëtarë të tjerë të trupës aktuale të Gjykatës Kushtetuese, të jenë të përfshirë në këtë shkelje të rëndë të ligjit dhe të etikës, që diskretiton figurën e gjyqtarit kushtetues, por këtë do të duhet ta zbardhë hetimi disiplinor.

Gjithsesi dyshimi i bazuar dhe i mbështetur në provat që kemi në dispozicion bie fillimisht tek Relatori i çështjes, gjyqtarja Fiona Papajorgji, e cila ka për detyrë të kujdeset për dosjen dhe relatimin dhe veprimet e plota mbi të, por referuar faktit të caktimit si relatore pa short; qëndrimeve të saj individuale të mbajtura prej saj fillimisht në kolegji, apo më pas në mbledhjen e gjyqtarëve, për të mos kaluar për shqyrtim çështjen më të rëndësishme të vendit, krijojnë të gjithë dyshimin e arsyeshëm mbi njëanshmërinë e saj, në favor të organit të emërtesës që e ka zgjedhur atë në këtë detyrë (Kuvendit të Shqipërisë) dhe Këshilli i Ministrave, mazhorancën e të cilave e mbizotëron subjekti politik Partia Socialiste, e cila përmes përfaqësuesve të saj në KQZ dhe përmes një rezolute të Kuvendit, realizuan pa garë, pa dekret të Presidentit, dhe pa alternativa, zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019, duke bërë të mundur kapjen totale përmes emërimeve politike të gjithë pushtetit vendor, si të gjithë Kryetarëve të Bashkive ashtu dhe të gjithë anëtarëve të Këshillave Bashkiakë?

Një pyetje tjetër shumë e rëndësishme që Kolegji i Posaçëm i Apelit, duhet ta zbardhë përmes një hetimi disiplinor të thelluar dhe që duhet t'i marrë shpjegimë zonjës Fiona Papajorgji dhe gjithë trupës gjyqësore kushtetuese është:

- **A ka marrë pjesë dhe a ka votuar zonja Fiona Papajorgji apo ndonjë anëtar tjetër i trupës gjyqësore në procesin e votimeve të 30 qershorit 2019?**
- **Nëse po, gjyqtarët që kanë marrë pjesë dhe kanë votuar në 30 qershor 2019, a kanë qenë në një situatë të papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit që sipas nenit 36 pika 1/b, ç, i detyronte ata që të hiqnin dorë nga shqyrtimi i kësaj çështje?**

Nëse një gjyqtar Kushtetues, ka shkuar dhe ka votuar në votimet e 30 qershorit 2019, si mund të ishte ai një gjyqtar objektiv, i paanshëm për të shqyrtuar atikushtetutshmërinë e këtij procesi votimesh?!

III. Kuadri ligjor në fuqi i shkelur dhe autorizimi ligjor për KPA-në në nisjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, përcakton qartë se:

Neni 124

- 1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.*
- 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.*
- 3. Gjykata Kushtetuese ka buxhet të veçantë, të cilin e administron në mënyrë të pavarur.*

Neni 126

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve kur ai ka vepruar për një interes vetjak ose me keqbesim.

Neni 128

- 1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit.*
- 2. Procesi disiplinor ndaj gjyqtarit zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos për shkarkimin e tij kur:
 - a) konstaton shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të mandatit;*
 - b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.**
- 3. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:*

- a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
- b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje;
- c) **fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.**”

2. Ligji Nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, përcakton se:

“Neni 10

Shkeljet disiplinore

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore, veçanërisht për shkaqe të:
 1. Mosparaqitjes së kërkesës për heqje dorë nga procedimi apo gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit procedural dhe gjyqtari është në dijeni të rrethanave të tilla.

2. Sjelljes, akteve dhe veprimeve të tjera të gjyqtarit që krijojnë përfitime të padrejta ose dëme për palët pjesëmarrëse në gjykim.

[...] 5. Mosnjoftimit të Kryetarit dhe të institucioneve përgjegjëse për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit të tij.

[...]13. **Parashtrimi të shtrembëruar të fakteve në aktet e nxjerra.** [...]

Neni 10/a

Fillimi dhe zhvillimi i procedimit disiplinor

1. **Kur ka të dhëna të mjaftueshme** se një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka kryer shkelje të parashikuara në nenin 128, të Kushtetutës, dhe në nenin 10, të këtij ligji, me kërkesë të Kryetarit ose të çdo gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, Kryetari, ose gjyqtari më i vjetër në detyrë, kur subjekti i procedimit është Kryetari, merr masat për fillimin e procedimit disiplinor.

2. **Procedimi disiplinor fillon menjëherë nga momenti i konstatimit të shkeljes.** Procedimi disiplinor pushon nëse gjyqtari jep dorëheqjen. Në këtë rast ai nuk ka të drejtë të emërohet më në funksione publike për një periudhë 15-vjeçare.

3. Dy gjyqtarë të caktuar me short mbledhin fakte, prova dhe të dhëna të tjera lidhur me shkeljen që i atribuohet gjyqtarit dhe brenda 30 ditëve përgatisin relacionin përkatës dhe ia dërgojnë atë për shqyrtim Komisionit Disiplinor.

4. Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të caktuar me short, pa pjesëmarrjen e gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhjen e fakteve dhe provave, sipas pikës 3 të këtij neni. Komisioni merr në shqyrtim relacionin e paraqitur dhe vendos dhënien e masës disiplinore, sipas nenit 10/b, të këtij ligji, ose pushimin e çështjes për shkak se nuk provohet shkelja.

5. Gjyqtari, subjekti i procedimit, ka të drejtë të ushtrojë ankim ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor. Ankimi shqyrtohet nga komisioni ad hoc i përbërë nga tre gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, që nuk kanë marrë pjesë në procedim, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni.

Neni 10/b

Masat disiplinore

1. Ndaj gjyqtarit mund të vendosen këto masa disiplinore:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje publike;
- c) ulje e përkohshme e pagës deri në 50 për qind për një periudhë jo më të gjatë se 1 vit;
- ç) pezullim nga detyra për një periudhë nga 3 muaj deri në 6 muaj;
- d) shkarkim nga detyra.

2. Gjatë kohës së procedimit disiplinor, gjyqtari pezullohet nga detyra, sipas nenit 10/ç, të këtij ligji, dhe përfiton 50 për qind të pagës së tij.

Neni 10/c

Shqyrtimi i shkeljes disiplinore

1. Komisioni Disiplinor shqyrton çështjen brenda 10 ditëve nga paraqitja e relacionit dhe vendos:

- a) dhënien e masës disiplinore;
- b) rrëzimin e propozimit për masë disiplinore;
- c) kthimin e çështjes për mbledhje të provave dhe fakteve të tjera;
- ç) pushimin e çështjes, kur gjyqtari jep dorëheqjen nga detyra ose i mbaron mandati.

2. Vendimi i njoftohet gjyqtarit të proceduar dhe në çdo rast publikohet. Kur ndaj gjyqtarit të proceduar vendoset shkarkimi nga detyra, vendimi i dërgohet organit të emërtesës.

Neni 10/ç

Pezullimi i gjyqtarit nga detyra

1. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve kur:

- a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi”;
- b) merr cilësinë e të pandehurit;
- c) fillon procedimi disiplinor, sipas këtij ligji.

2. Kryetari ose gjyqtari më i vjetër në detyrë, kur subjekt procedimi është Kryetari, brenda tri ditëve nga marrja dijani e shkaqeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, thërret Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila vendos për masën e pezullimit ndaj gjyqtarit. Vendimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve është përfundimtar.

3. Gjyqtari i pezulluar nuk merr pjesë në shqyrtimin e çështjeve deri në heqjen e masës së pezullimit nga Mbledhja e Gjyqtarëve.

4. Kryetari merr masa për caktimin e një relatori të ri për çështjet e caktuara gjyqtarit të pezulluar.

Neni 86

Zbatimi i ligjit të ri

1. Shqyrtimi i shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 10, të këtij ligji, për një periudhë 9-vjecare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, do të bëhet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, sipas parashikimeve të ligjit

nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Referuar dispozitave të mësipërme, porse dhe fakteve të pamohueshme që evidentohen lehtësisht nga praktika bashkëlidhur, siç është vënë në dispozicion nga ana e Gjykatës Kushtetuese, lind një dyshimin më se i bazuar se në shqyrtimin e kërkesës së Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, finalizuar me Vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese,

1) Janë shmangur/shkelur në mënyrë të pakontestueshme rregullat procedurale të parashikuara nga ligji, për caktimin me short të relatorit të çështjes, duke krijuar dyshime të forta se fati i kësaj dosje ishte paracaktuar në favor të organit të emërtesës dhe mazhorancës përfaqësuese që ka zgjedhur/emëruar gjyqtarin kushtetues relator (F.P);

2) Relatori i çështjes, përmes mos pasqyrimin të procesit vendimmarrës, si për administrimin e çështjes pa short, ashtu dhe për ndërtimin e pyetjeve drejtuar Komisionit të Venecias, ka konsumuar shkelje të rënda profesionale, por dhe etike, që kanë favorizuar disa palë në gjykim, dhe që kanë cenuar të drejtat e disa palëve të tjera, veprime këto që kanë diskredituar pozitën dhe figurën e një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese.

3) Këto veprime të relatorit të çështjes, krijojnë idenë se janë kryer jo vetëm për përfitime të padrejta (në rastin konkret në formën e një kthimi të “shpërblimit” për organin e emërtesës që e ka zgjedhur), por edhe i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm palëve pjesëmarrëse në gjykim, të cilëve u është mohuar e drejta për të marrë përgjigje për pyetjet e ngritura për Komisionin e Venecias, me impakt direkt edhe në mënyrën se si Gjykata Kushtetuese do të orientonte më pas zgjidhjen e çështjes të paraqitur para saj për shqyrtim. Mosdërgimi i pyetjeve të palëve në Komisionin e Venecias, veç të tjerash bie në kundërshtim me vendimin e ndërmjetëm të Gjykatës Kushtetuese të datës 23.6.2021.

4) Këto veprime të relatorit të çështjes, krijojnë dyshimin e arsyeshëm se janë kryer në kushtet e papajtueshmërisë së tij, dhe duke paraqitur faktet në mënyrë të shtrembëruar në shkresën e nxjerrë drejtuar Komisionit të Venecias.

Presidenti i Republikës, në këtë gjykim, si palë e interesuar, i kërkoi Gjykatës Kushtetuese, e cila është instanca e vetme e ngarkuar me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese, kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve apo vendimeve të nxjerra nga organet e pushtetit shtetëror, **që të përmbushë rolin, misionin dhe përgjegjësitë që Kushtetuta i ka dhënë**, në mënyrë të pavarur, të pandikuar, me kurajë e përgjegjshmëri të plotë, në mënyrë që të gjithë shqiptarëve t’i ofrohej një vendimmarrje e plotë mbi themelin e kërimit, duke adresuar dhe orientuar njëkohësisht dhe mënyrën e zgjidhjes së pasojave të rënda që kanë ardhur nga një proces votimesh monist, antikushtetues, i njëanshëm dhe fiktiv, siç ishte ai i 30 qershor 2019.

Vetëm përmes një vendimmarrje të themeltë, Gjykata Kushtetuese, do t'i rikthente popullit shqiptar mundësinë që të shprehte vullnetin e tij përmes një procesi zgjedhor të lirë, të ndershëm, të fshehtë, dhe në përmbushje të gjithë standardeve kushtetuese, ligjore e ndërkombëtare, për të zgjedhur përfaqësuesit e tij në pushtetin vendor.

Por përkundër kësaj pritshmërie të lartë dhe legjitime, para së gjithash të popullit shqiptar, por dhe të institucioneve ndërkombëtare, të cilët e kishin kushtëzuar ecurinë e procesit të çeljes së negociimit dhe integritit të Shqipërisë, me plotësimin edhe të kushtit që Shqipëria, do duhej të kishte një vendim përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese mbi zgjedhjet lokale të 30 qershorit 2019, kjo Gjykatë për fat të keq, i zhgënjeu të gjithë, për shkak të shtrembërimit të fakteve që kërkonin adresim.

Veprimet e sipër evidentuara të Relatorit të çështjes, ku mund të jenë përfshirë dhe gjyqtarë të tjerë, për interesa që nuk përkrijnë me ato të popullit shqiptar, bënë që Gjykata Kushtetuese të vijonte më pas me një vendim ku ajo hoqi dorë nga ushtrimi i funksionit të saj sublim dhe kjo Gjykatë të shpallte veten jo kompetente, për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të shqiptarëve, parimeve dhe vlerave më të larta tona shoqërore e morale mbi të cilat ne si shqiptarë kemi vendosur të ndërtojmë jetën tonë, në një shoqëri me demokraci funksionale.

Nëse Gjykata Kushtetuese, do të kishte trajtuar pa anashkaluar secilën prej pyetjeve që palët kërquan që t'i adresoheshin Komisionit të Venecias, sot do të kishim një vendim themeli.

Pyetja që ngriti shoqata e Bashkive, ishte në vetvete themeli i çështjes.

Gjykata Kushtetuese, në datën 09.07.2021, i dërgoi Komisionit të Venecias kërkesën për dhënien e një opinionit, **duke injoruar dhe fshehur** pyetjen që kishte kërkuar Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, dhe duke orientuar Komisionin e Venecias të shprehej **vetëm për 3 pyetjet, që nuk pasqyrohen si dhe kush i ka hartuar, ç'ka bën që përgjegjësia të jetë direkte e Relatorit të çështjes.**

Këto pyetje të dërguara nga Relatori, jo vetëm që nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e gjykimit, por në mënyrën se si ato u formuluan, qartazi kërkonin të orientonin dhënien e një Opinioni që do të shërbente për të legjitimuar vendimmarrjen e mëvonshme, për shpalljen e Gjykatës Kushtetuese si jo kompetente për shqyrtimin e çështjes.

Kjo është një nga shkeljet më të rënda të Gjykatës Kushtetuese, që përmes një procesi jo transparent, duke cenuar procesin e rregullt ligjor, dhe barazinë e palëve në gjykim, i mohoi Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, të drejtën për të marrë një përgjigje përfundimtare për pyetjen që kishte ngritur.

Madje, Gjykata Kushtetuese as nuk e njoftoi këtë të fundit (Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë) dhe as i dha asaj ndonjë shpjegim për këtë fakt, veprime këto që duhet të kryheshin nën përgjegjësinë e Relatorit të çështjes.

Çështja e zgjedhjeve për pushtetin vendor të 30 qershorit 2019, ishte një nga çështjet më të rëndësishme të karakterit kushtetues dhe me interes të lartë publik, për shkak se ajo lidhet drejtpërdrejtë me përmbushjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë për një qeverisje vendore transparente, të pavarur e njëkohësisht objektive. Ndërkohë që qytetarëve shqiptarë ju mohua e drejta për t'u shqyrtuar themeli i kësaj çështjeje, duke bërë që Gjykata Kushtetuese të mos përmbushte misionin e saj sublim, por me vendimin e marrë la pa asnjë zgjidhje situatën, përkundër kërkesave të interesit më të lartë të vendit.

Për sa më sipër, referuar dispozitës tranzitore mbi organin që ka kompetencën e hetimit disiplinor të Gjykatës Kushtetuese, si President i Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësues i unitetit të popullit, kur konstatoj se në këtë proces janë shkelur jo vetëm të drejtat e kërkuarit, apo palëve të tjera të interesuara, por dhe për nga rëndësia kushtetuese e institucioneve të përfshira në këtë proces dhe atë që ata përfaqësojnë, rezultojnë se janë shkelur të drejtat themelore të qytetarëve të vendit, nga mënyra e veprimit jo profesionale e një apo disa gjyqtari/rëve kushtetues, dhe për të cilat si President i Republikës kam detyrimin t'i vë në dispozicion Kolegjit të Posaçëm të Apelit, faktet e mësipërme dhe kopjen e dokumentacionit që administroj dhe që më është përcjellë nga Gjykata Kushtetuese për këtë çështje, me kërkesën që të nisët menjëherë hetimi dhe procedimi disiplinor ndaj Relatorit të çështjes, znj. Fiona Papajorgji, apo dhe për anëtarë të tjerë të kësaj gjykate që do të rezultojnë të përfshirë në këtë veprimtari të kundraligjshme nga hetimi dhe procedimi disiplinor që ju do të kryeni.

Duke besuar në një veprim të shpejtë, objektiv, të pavarur dhe hetim të plotë e të gjithanshëm nga ana juaj.

Bashkëlidhur, shkresa Nr.3803/2 Prot, datë 9.12.2021 e Presidentit të Republikës, përgjigja nr. prot. 466/1, datë 16.12.2021 e Gjykatës Kushtetuese, lista e inventarit e konfirmuar dhe sekretuar zyrtarisht bashkëlidhur shkresës së saj, si dhe kopja e plotë e dosjes gjyqësore të dërguar që i është përcjellë Institucionit të Presidentit të Republikës.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META